



MIRELA KARABINA

DOKTOR I SHKENCAVE

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

Dr. Mirela Karabina është pjesë e stafit akademik të Universitetit Barleti

FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

- Pedagogji

EMAIL

m.karabina@umb.edu.al

BIO

Dr. Mirela Karabina është Doktore e Shkencave të Edukimit e diplomuar me titullin “Doktor” pranë Universitetit të Tiranës, Fusha Pedagogji.

Prej Korrikut 2021, Dr. Mirela Karabina është pjesë e stafit akademik të Universitetit Barleti.

Në vitin 2011 ka kryer studimet pasuniversitare në Master Shkencor “Kërkim në Edukim”, pranë Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Shkencave Sociale, Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë. Është diplomuar si mësuese e Lëndëve Gjuhë dhe Letërsi pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan. Ka përvojë të gjatë profesionale në fushën e mësimdhënies si mësuese, pedagoge dhe trajnere në edukim. Gjithashtu ka përvojë në drejtimin dhe menaxhimin e institucioneve arsimore.

Dr. Mirela Karabina si kërkuese në edukim, ka referuar në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe ka publikuar artikuj shkencor në revista shkencore shqiptare dhe ndërkombëtare.

Dr. Mirela Karabina është angazhuar në stafin akademik në institucionet e arsimit të lartë si pedagoge e lëndëve: Menaxhim dhe Administrim në Arsim, Zhvillim Kurrikule, Vlerësimi në Arsim, Metoda të Mësimdhënies, Mendimi Kritik, Menaxhim Klase, Politikat Arsimore, Bazat Kulturore të Edukimit, Didaktika e Gjuhës Shqipe, Metodatat e Kërkimit Shkencor, Shkrimi Akademik.

Në Maj 2017 ka mbajtur postin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.